

## SKUPŠTINA OPŠTINE TUZI

n/r g-dinu Fadil Kajoshaj – predsjedniku

**PREDMET:** Dostava Predloga Odluke**NAPOMENA:** Uvrstiti u dnevni red naredne sjednice Skupštine Opštine**PODNOŠILAC PREDMETA:** Predsjednik Opštine**OBRAĐIVAČ AKTA:** Sekretarijat za poljoprivredu i ruralni razvoj**PRILOG:** Predlog Odluke sa obrazloženjem

Poštovani,

Odredbom člana 59 Zakona o lokalnoj samoupravi ("Službeni list CG", br. 2/18, 34/19, 38/20) je propisano da predsjednik opštine privremeno donosi akte iz nadležnosti skupštine ako skupština nije u mogućnosti da se sastane ili je iz drugih razloga onemogućen njen rad, a njihovim nedonošenjem bi se ugrozio život građana ili imovina veće vrijednosti, da je predsjednik dužan da akt iz stava 1 ovog člana podnese na potvrdu skupštini na prvoj narednoj sjednici, te da ako skupština ne potvrdi akt iz stava 1 ovog člana ili ga predsjednik ne podnese na potvrdu, taj akt prestaje da važi u roku od tri mjeseca od dana donošenja.

Kako je navedeni akt iz nadležnosti Skupštine, shodno članu 59 stav 2 Zakona o lokalnoj samoupravi, Odluku o uslovima, načinu i dinamici raspodjele sredstava Budžeta opštine Tuzi za 2020.godinu namijenjenih za poljoprivredu broj 01-031/20-3325 od 17.04.2020.godine, podnosim na potvrdu Skupštini opštine Tuzi.

Za predstavnicu predlagača koja će učestvovati u radu Skupštine i njenih radnih tijela prilikom razmatranja ovog materijala određuje se Ismeta Gjoka VD sekretarke Sekretarijata za poljoprivredu i ruralni razvoj.

## KUVENDIT TË KOMUNËS SË TUZIT

Z. Fadil Kajoshaj - Kryetar

**LËNDA:** Dorëzimi i Propozim Vendimit**VËREJTJE:** Të përfshihet në rendin e ditës në seancën e rralës së Kuvendit të Komunës**PARASHTRUESI I PROPOZIMIT:** Kryetari i Komunës**PËRPUNUESI I AKTIT:** Sekretariati për bujqësi dhe zhvillim rural**SHTOJCË:** Propozimi i Vendimit me arsyetim

I nderuar,

Me dispozitat e nenit 59 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale ("Fleta zyrtare e MZ" nr. 2/18, 34/19, 38/20) është paraparë që kryetari i komunës përkohësisht mund të sjellë akte nga kompetencat e kuvendit nëse kuvendi nuk është në gjendje që të mbledhet ose nga arsye të ndryshme i pamundësohet puna e tij, e me mos sjelljen e tyre do të rrezikohet jeta e qytetarëve ose pronat me vlerë të madhe, që kryetari është i obliguar që aktin nga paragrafi 1 i këtij neni t'ia dorëzojë për miratim kuvendit në seancën e parë të rregullt, e nëse kuvendi nuk e miraton aktin nga paragrafi 1 i këtij neni ose kryetari nuk e dorëzon në verifikim, ai akt pushon së vlejture në afat prej tre muajsh nga dita e sjelljes.

Duke marrë parasysh se akti në fjalë është kompetencë e Kuvendit, në bazë të nenit 59 paragrafi 2 të Ligjit mbi vetëqeverisje lokale, Vendimin mbi kushtet, mënyrën dhe dinamikën e ndarjes së mjeteve të Buxhetit të komunës së Tuzit për vitin 2020 të destinuar për bujqësi numër 01-031/20-3325 prej më 17.04.2020, e parashtror në verifikim Kuvendit të komunës së Tuzit.

Për përfaqësuese të propozuesit e cila do të marrë pjesë në punën e Kuvendit dhe trupave punues të tij gjatë shqyrtimit të këtij materiali, përcaktohet Ismeta Gjoka, UD së sekretares së Sekretariatit për bujqësi dhe zhvillim rural.

S poštovanjem,

Me respekt,

**PREDSJEDNIK – KRYETARI,**  
Fadil Kajoshaj  
Nik Gjelošhaj  
Nik Gjelošhaj



Në bazë të nenit 38 paragrafi 1 pika 2, kurse në lidhje me nenin 59 të Ligjit mbi vetëqeverisje lokale („Fleta Zyrtare e MZ“, nr. 2/18, 34/19, 38/20) dhe me nenin 24 paragrafi 1 pika 22 të Statutit të Komunës së Tuzit (“Fleta Zyrtare e MZ”, nr. 24/19, 05/20), Kuvendi i Komunës së Tuzit në seancën e mbajtur më \_\_\_\_\_ .2020 ka sjellë:

## **VENDIM**

### **mbi verifikimin e Vendimit mbi kushtet, mënyrën dhe dinamikën e shpërndarjes së Buxhetit të komunës së Tuzit për vitin 2020 të destinuar për bujqësinë**

#### **Neni 1**

Verifikohet Vendimi mbi kushtet, mënyrën dhe dinamikën e shpërndarjes së Buxhetit të komunës së Tuzit për vitin 2020 të destinuar për bujqësinë, numër 01-031/20-3325 prej më 17.04.2020, të cilën e ka sjellë kryetari i Komunës së Tuzit.

#### **Neni 2**

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e tetë nga dita e publikimit në “Fletën zyrtare të Malit të Zi – dispozitat komunale”.

Numër: 02-030/20-  
Tuz, \_\_\_\_\_ .2020

**KUVENDI I KOMUNËS SË TUZIT**  
**KRYETARI,**  
**Fadil Kajoshaj**



## ARSYETIM

### BAZA JURIDIKE

Me nenin 59 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale („Fleta Zyrtare e MZ“, nr. 02/18, 34/19, 38/20) është paraparë që: kryetari i komunës përkohësisht mund të sjellë akte nga kompetencat e kuvendit nëse kuvendi nuk është në gjendje që të mblidhet ose nga arsye të ndryshme i pamundësohet puna e tij, e me mos sjelljen e tyre do të rrezikohet jeta e qytetarëve ose pronat me vlerë të madhe, që kryetari është i obliguar që aktin nga paragrafi 1 i këtij neni t’ia dorëzojë për miratim kuvendit në seancën e parë të rregullt, e nëse kuvendi nuk e miraton aktin nga paragrafi 1 i këtij neni ose kryetari nuk e dorëzon në verifikim, ai akt pushon së vlejture në afat prej tre muajsh nga dita e sjelljes.

Me nenin 24 paragrafi 1 pika 22 të Statutit të Komunës së Tuzit (“Fleta Zyrtare e MZ”, nr. 24/19, 05/20) me të cilin është e përcaktuar që Komuna e Tuzit në pajtueshmëri me ligj dhe dispozita të tjera krijon kushtet për zhvillimin e prodhimeve bujqësore (pemëtarisë, perimtarisë, kultivimit të ullirit etj.) dhe kryen punë të tjera nga kjo lëmi.

### ARSYET PËR SJELLJEN

Me këtë Vendim verifikohet Vendimi i kryetarit të Komunës së Tuzit nr 01-031/20-3325 prej më 17.04.2020, me të cilin sjellët Vendimi mbi kushtet, mënyrën dhe dinamikën e shpërndarjes së Buxhetit të komunës së Tuzit për vitin 2020 të destinuar për bujqësinë.

Ky program masash përcakton kushtet, mënyrën dhe dinamikën e shpërndarjes së buxhetit të Komunës së Tuzit për vitin 2020 për bujqësinë, politikën e çmimeve të tregut, blerjen e produkteve bujqësore, korrjen e drithërave, prodhimin e qumështit në treg dhe zhvillimin e sipërmarrjes për gratë në bujqësi. Fondet e siguruara nga Buxheti i Komunës së Tuzit, klasifikimi ekonomik nr. 418 dhe 431 të alokuara në shumën totale 110,000.00 € dhe klasifikimi ekonomik Nr. 43181 i ndarë në shumën totale prej 10,000.00 €. Fondet e siguruara nga Buxheti i Komunës Tuzi, klasifikimi ekonomik nr. 418 dhe 431, transferimet Nr. 43181 do të shpenzohen si më poshtë: mbështetje për zhvillimin e prodhimit të qumështit në treg 60,000.00 €; rreziqet në bujqësi në vlerë prej 23,000.00 € (pjesëmarrja në sigurimin e prodhimit bujqësor 3,000.00 € ndërhyrja në treg 15,000.00 € dhe mbështetja për korrjen e drithërave 5,000 €); tregtimi i produkteve bujqësore (panaire, etj.) 6,000.00 €, blerja e makinerive bujqësore dhe pajisjeve 21,000.00 € dhe mbështetje për zhvillimin e sipërmarrjes për gratë në bujqësi në vlerë prej 10,000.00 €.

Me ligj parashihet që kryetari përkohësisht sjellë vendime nga kompetencat e kuvendit nëse kuvendi nuk është në gjendje që të mblidhet ose për arsye tjerë pamundësohet puna e tij, kurse për arsye të mos sjelljes mund të rrezikohen të drejtat e qytetarëve si dhe rrezikohet prona në përmasa më të mëdha.

Me ligj është e paraparë që kryetari është i detyruar që aktin e sjellë të ja shtroj në verifikim kuvendit në mbledhjen e ardhshme. Nëse kuvendi nuk e verifikon apo kryetari nuk e dërgon në verifikim, ai akt skadon ditën e fundit të mbajtjes së mbledhjes.

Ky vendim hynë në fuqi ditën e 8 nga dita e publikimit në “Fletën zyrtare e MZ- dispozitat komunale.

Në bazë të nenit 59 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale („Fleta zyrtare e Malit të Zi“, nr. 002/18, 34/19), e në lidhje me nenin 24 paragrafi 1 pika 22 të Statutit të Komunës së Tuzit (“Fleta Zyrtare e MZ”, nr. 24/19, 05/20), kryetari i komunës së Tuzit sjellë:

## VENDIM

### MBI KUSHTET, MËNYRËN DHE DINAMIKEN E SHPËRNDARJES SË BUXHETIT TË KOMUNËS SË TUZIT PËR VITIN 2020 TË DESTINUARA PËR BUJQËSINË

#### Neni 1

Me këtë Vendim përcaktohen kushtet, mënyra dhe dinamika e shpërndarjes së mjeteve buxhetore të Komunës së Tuzit për vitin 2020, të destinuara për bujqësinë, përmes përkrahjes së zhvillimit të tregut prodhues të qumështit, menaxhimin e rrisqeve në bujqësi (pjesëmarrja në sigurimin e prodhimit bujqësor, ndërhyrja në treg dhe mbështetja për korrijen e drithërave), tregtimi i produkteve bujqësore (panaire, etj.), prokurimi i makinerive dhe pajisjeve bujqësore, dhe zhvillimi i afarizmit për gratë në bujqësi.

#### Neni 2

Mjetet e parashikuara në Buxhetin e Komunës së Tuzit, Klasifikimet Ekonomike me nr. 418 dhe 431 të ndara në shumën totale prej 110.000,00 € dhe klasifikimi funksional nr. 43181 i ndarë në vlerë prej 10.000,00 € do të shpenzohen për përbërësit e mëposhtëm:

Nr. R.	Emri i komponentës	Shuma (në €)
1.	Përkrahje e zhvillimit të tregut prodhues të qumështit	60.000,00
2.	Menaxhimi i rrisqeve në bujqësi	23.000,00
2.1	<i>Pjesëmarrje në sigurimin e prodhimit bujqësor</i>	<i>3.000,00</i>
2.2	<i>Intervenime në treg</i>	<i>15.000,00</i>
2.3	<i>Mbështetje për korrijen e drithërave</i>	<i>5.000,00</i>
3.	Prokurimi i pajisjeve dhe makinerisë bujqësore	21.000,00
4.	Marketingu i prodhimeve bujqësore	6.000,00
5.	Zhvillimi i afarizmit të femrës në bujqësi	10.000,00
<b>TOTALI</b>		<b>120.000,00</b>



### Neni 3

Për përgjegjësinë operative përgjegjës është kryetari i Komunës, përderisa për implementim është përgjegjës Sekretariati për bujqësi dhe zhvillim rural si dhe Sekretariati për vetëqeverisje lokale (për masën Zhvillimi i afarizmit për femrat në bujqësi).

Kryetari i Komunës Sekretariati për bujqësi dhe zhvillim rural si dhe Sekretariati për vetëqeverisje lokale mundën që përmes marrëveshjes gjatë përbarimit të linjës buxhetore të bëjnë ndryshime të qëllimit të shfrytëzimit të mjeteve nga neni 2 i këtij Vendimi dhe ti ridrejtojnë nga një linjë në tjetrën deri në shumën e përgjithshme të mjeteve.

### Neni 4

Ky vendim do të hyjë në fuqi ditën e sjelljes dhe do të publikohet në "Fletën Zyrtare të Malit të Zi - dispozitat komunale".

Numër: 01-031/20-3325

Tuz, 17.04.2020

**KOMUNA E TUZIT**

**Kryetari,**

**Nik Gjeloshaj**

